



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 1690/4 Prot.

Divjakë më 20.02. 2026

THIRRJE

**“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK
DIVJAKË, MUAJI SHKURT, 2026”**

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijeni:

**KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, **Ju njoftojmë se: Më datë: 27.02.2026, ditën e Premte, ora 10:00,** tek Salla e mbledhjeve, kati i dytë, në Godinën e Bashkisë Divjakë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin **Shkurt 2026**”. **Me këtë Rend dite:**

- 1.Miratim i Rendit të Ditës.
- 2.Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 27.01.2026.
- 3.Information mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Janar 2025.
- 4.**Projekt-vendim Nr.09.datë,09.02.2026:** Për themelimin e Shoqatës sportive jofitimprurëse “Klubi sportiv Arnisa”, miratimin e Aktit të themelimit dhe Statutit.
- 5.**Projekt-vendim Nr.10.datë, 09.02.2026:** Për pakësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Divjakë për vitin 2026 , nga të ardhurat e trashëguara (Kapitulli 01).
- 6.**Projekt-vendim Nr. 11.datë, 09.02.2026:** Për miratimin e riemërtimit të projektit të investimit , në Buxhetin e vitit 2026.
- 7.**Projekt-vendim Nr. 12.datë, 09.02.2026:** Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2026.
- 8.**Projekt-vendim Nr. 13.datë, 09.02.2026:** Për pakësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Divjakë, për vitin 2026, nga financimet e huaja.
- 9.**Projekt-vendim Nr. 14.datë, 12.02.2026:** Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Janar 2026.
- 10.**Projekt-vendim Nr. 15.datë, 13.02.2026:** Për miratimin e bashkëfinancimit për “ Projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese, për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara, për vitin 2026”.
- 11.**Projekt-vendim Nr. 16.datë, 16.02.2026:** - Për mbulimin e tarifës së ushqimit të kopështit me drekë nga Bashkia Divjakë për fëmijën e z. Landi Beno.
- 12.**Projekt-vendim Nr. 17.datë, 17.02.2026:** Për miratimin e Raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitet, 2027-2029.
- 13.**Projekt-vendim Nr. 18.datë, 18.02.2026:** Për ndryshime të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.90 datë, 29.12.2025 “ Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Divjakë, Njësie Administrative dhe Institucioneve në vartësi për vitin 2026”



14. Projekt-vendim: Nr. 19.datë, 18.02.2026: Për miratimin e një shtese në Buxhetin e vitit 2026 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025.

15. Projekt-vendim: Nr. 20.datë, 19.02.2026: Për dhënien e ndihmës financiare për fermerët që kanë pësuar dëme nga përmbytjet e muajve Janar- Shkurt 2026.

16. Projekt-vendim: Nr. 21.datë, 19.02.2026: Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 90 datë 29.12.2025 “ Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Divjakë, Njësive Administrative dhe Institucioneve në vartësi për vitin 2026”

17. Projekt-vendim: Nr. 22.datë, 19.02.2026: Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme , për vitin 2026 në Bashkinë Divjakë.

18. Projekt-vendim: Nr. 23.datë, 19.02.2026: Për transferimin e fondeve nga Buxheti i Bashkisë, në shoqërinë “ Rrjela Sh.P.K.”

19. Shqyrtim i kërkesës së Kryetarit të Bashkisë mbi zbatimin e hierarkisë së akteve normative dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për funksionin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak për shkak të plotësimit të moshës së daljes në pension. (Për herë të dytë)

Njoftim: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:-Komisioni i Ekonomisë dhe i financave, për pikat nr: 5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18. -Komisioni i Arsimit, Rinisë, Kulturës, Sporteve dhe Turizmit për pikën nr.4.- Komisioni i bujqësisë dhe emergjencave civile, për pikën 15.

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Liri Biti

